



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1358/5prot

Datë 27.07.2022

V E N D I M
Nr. 722/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.07.2022 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*ABISSNET*” SHA në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur- e thjeshtuar- Shërbim, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. *REF-23552-03-30-2022*, me objekt: “*Shërbim interneti për UKT sh.a*” me fond limit 4.003.700 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*ALBTELECOM*” SHA
Adresa: Rruga “Muhedin Llagani”, Kompleksi Square 21 Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA
Adresa: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “*ABISSNET*” SHA
Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Ismail Qemali” Pallati 18, Kati II, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 31.03.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur- e thjeshtuar- Shërbim, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-23552-03-30-2022, me objekt: “Shërbim interneti për UKT sh.a” me fond limit 4.003.700 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA.

II.2. Në datën 13.05.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 13.06.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ABISSNET” SHA 2,408,182 lekë pa tvsh kualifikuar
2. “ALBTELECOM” SHA 2,432,385.55 lekë pa tvsh kualifikuar
3. BOE “Tibo” SHPK & “Tibo Communication” SHPK 2,443,310 lekë pa tvsh skualifikuar
4. “VODAFONE ALBANIA” SHA 2,595,150 lekë pa tvsh kualifikuar
5. “Digicom” SHPK 2,666,400 lekë pa tvsh kualifikuar

II.4. Në datën 22.06.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike “Njoftimin e Fituesit”, prej të cilës rezulton fitues operatori ekonomik “ABISSNET” SHA.

II.5. Në datën 27.06.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.1358 prot e operatorit ekonomik “ALBTELECOM” SHA, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur- e thjeshtuar- Shërbim, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-23552-03-30-2022, me objekt: “Shërbim interneti për UKT sh.a” me fond limit 4.003.700 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Tiranë SHA.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ABISSNET” SHA.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mosparaqitje nga ana e operatorit ekonomik “ABISSNET” SHA të dokumentacionit të plotë në përputhje me shtojcën 9 të dokumentave të tenderit, mospërbushje nga ana e operatorit ekonomik “ABISSNET” SHA të kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikat 2.3.7, 2.3.8, 2.3.11, 2.3.12 të Shtojcës 7 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit dhe specifikimeve teknike lidhur me kapacitete të bandëit dhe shërbimin back — up me si më poshtë vijon:

Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

[Vendndodhja dhe data]

[Emri dhe adresa e Autoritetit/ Kontraktor]

[Adresa e Ofertuesit]

I nderuar, Z. / Znj. <Emri i kontaktit >

Ju falënderojmë për pjesëmarrjen tuaj në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit publik.

Procedura u zhvillua në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në

Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informojmë se jeni skualifikuar

pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për arsyen (et) e mëposhtme:

Nëse mendoni se autoriteti kontraktor ka shkelur LPP-në ose RPP-në gjatë procedurës së prokurimit publik, ju keni të drejtë të inicioni një procedurë rishikimi pas publikimit të njoftimit të fituesit sipas parashikimeve të Kapitullin XIV të Ligjit të Prokurimit Publik.

Megjithëse nuk mund t'i përdorim shërbimet tuaja në këtë rast, ne besojmë se do të mbeteni të interesuar për iniciativat tona të prokurimit.

Me respekt,

Titullari i Autoritetit Kontraktor

2.3.7. Rrjeti i komunikimeve elektronike (Data dhe Internet) të operatorit duhet të bazohet në teknologjinë IP-MPLS. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatorit ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se rrjeti i komunikimeve elektronike bazohet në teknologjinë IP-MPLS.

2.3.8. Operatori duhet të disponojë rrjet backbone të mbrojtur nga disa drejtime në mënyrë që të menjandohen problemet në rastin e dëmtimit të një drejtimi. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatorit ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon rrjet backbone të mbrojtur nga të gjitha drejtimet.

2.3.11. Operatori duhet të ketë support për BGP. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.11 operatorit ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon suport BGP.

2.3.12. Operatori duhet të disponojë strukture Helpdesk të dedikuara, të kontaktueshëm 24/7/365.

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

UKT sh.a ne funksion te permisimit te cilesise se sherbimit ndaj klienteve kerkon blerjen e sherbimit internetit nje sherbim qe behet cdo vit per te pasur lidhje me te gjitha arkat dhe pikat e shperndara ne territorin e Tiranes .Pa kete sherbim nuk kemi arketime apo sherbime tjera qe UKT sha u ofron klienteve te saj.Me shtimin e drejtorise rajonale apo kujdesit ndaj klientit dhe shtrirjen territoriale kerkohet nje shpjetesesi interneti me e madhe dhe nje sherbim me cilesor nga i meparshmi per te rritur sigurine ne komunikim .

Specifikimet Teknike Sherbimi i Internetit

Mënyra e ofrimit të këtij shërbimi duhet të jetë me transmetim të kablluar, (vetem) me fiber optike sipas tabelës së mesiperme. Te gjitha pikat duhet te kene linje backup me shpejtesine e kerkuar sipas tabelës.

Linjat kryesore fiber te paravendosura ne tabele duhen te jene me dy fije nje per doënload(doënstream) nje per upload(upstream).

Në drejtorinë qendrore pervec linjes kryesore kompania duhet te ofroje linje backup fiber optike kabell tel ose data gsm LTE me shpejtesesi (simetrike) data gsm LTE 40 Mbps me POP te ndryshem.

Në pikat e tjera mënyrë e ofrimit të shërbimit për pikat e tjera përveç linjës kryesore duhet të ofrohet linja back up fibër optike, kabëll ose data sim me shpejtësi simetrike data gsm LTE 40 Mbps me POP të ndryshëm

Kalimi duhet te behet automatike dhe linja backup te jete gjithe kohes online me sherbim.

Ne tabelen e meposhtme aty ku eshte e vendosur me fiber duhet me patjeter te vendoset vetem opsioni fiber. Shpejtesia duhet te jete simetrike.

Disponueshmeria e shërbimit 99.9 %.

Cilesia e shërbimit (QoS) të jetë jo me pak se 95%. Duhet të ofrohen 32 IP publike pa rekorde te keqija.

Ndërfaqe për monitorimin e vazhdueshëm të parametrave të shërbimit të Internetit.

Ping time me serverat neper Europe te jete me pak se 60 ms Linja te jete e optimizuar per protokollet e VOIP (latency dhe jitter te ulet)

Kompania brenda harkut kohor 1 vjecar duhet te pergjigjet deri ne 10 ndryshime pikash pozicionesh gjeografike nga ato te caktuara ne tabele.

Kompania duhet te parashikojë deri ne 10 pika te reja me kapacitet 32 Mbps/s

Shpejtesia e matjes se internetit duhet te behet duke pinguar servera te ndryshem ne Europe nepermjet ëebsite te ndryshem qe ofrojne sherbime testimi shpejtesie dhe jo peer to peer doënload .”.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

II.7. Në datën 04.07.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar shkresa me objekt “Formular i Paraqitjes së Argumentave” me nr.1358/3 prot., datë 04.07.2022 e operatorit ekonomik “ABISSNET” SHA.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 6244/18 prot., datë 07.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1358/4 prot., datë 12.07.2022, me objekt “Informacion mbi trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik “Albtelecom” sh.a”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit, vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Gjithashtu bashkëlidhur informacionit të mësipërm autoriteti kontraktor ka dorëzuar shkresën nr. K-1850/1 prot., datë 07.07.2022 me objekt “Kthim Përgjigje”, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ALBTELECOM” SHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.10. Në datën 07.07.2022 me anë të shkresës nr 6244/17 prot., me objekt “Informacion mbi ankesën e paraqitur për procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim Internet për UKT” sh.a”, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik të interesuar “ABISSNET” SHA mbi vendimin e marrë për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik “ALBTELECOM” SHA dhe ka vendosur refuzimin e ankesës, konkretisht citoj:

“Së pari referuar pretendimeve të shoqërisë ankimuese se shoqëria “Abissnet” sh.a nuk ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse propozimin teknik në përputhje me kërkesat teknike (kapacitete të bandëith të kërkuara dhe shërbimin bak up sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST), nuk ka ofruar një plan back up deri në pikën fundore, ju bëjmë me dije se Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin propozim teknik si pjesë të dokumentacionit kualifikues.

Përderisa Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit që operatorët pjesëmarrës të paraqesin propozim teknik si pjesë të dokumentacionit kualifikues, atëherë operatorët ekonomikë nuk kanë qënë të detyruar të paraqesin në sistemin e prokurimeve elektronike propozimin teknik.

Por megjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik Abissnet sh.a ka paraqitur propozim teknik pavarësisht faktit se nuk është kërkuar nga AK.

Akoma më tej Ju bëjmë me dije se në ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” neni 124/1 parashikohet...

1. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.

Në VKM-në nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet neni 107/1, 107/3 ...

1). Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore të autorizuar me ligj mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

3). Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti/enti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës sipas një plani zbatimi. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

Në bazë të dispozitave ligjore të mësipërme Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën e monitorimit të kontratës gjatë zbatimit të kësaj të fundit.

Nëse Autoriteti kontraktor do të konstatojë gjatë zbatimit se kontraktuesi nuk realizon kontratën sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga vetë AK, atëherë ky i fundit gëzon të drejtën e vendosjes të penalteteve deri në prishjen e kontratës.

Për sa cituam më lart pretendimi i ankimuesit nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk pranohet.

Së dyti në formularin e ankesës operatori ekonomik Altelecom sh.a pretendon se operatori ekonomik Abissnet sh.a nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë në përputhje me shtojcën 9 si dhe deklaratat e posaçme për efekt të dokumentacionit provues sipas pikave 2.3.7, 2.3.8, 2.3.11, 2.3.12 të kritereve të veçanta të kualifikimit.

Komisioni i Shqyrtimit të ankesave pasi mori në shqyrtim kushtet e veçanta të kualifikimit në të cilën është kërkuar si më poshtë cituar:

2.3.7. Rrjeti i komunikimeve elektronike (Data dhe Internet) te operatorit duhet te bazohet ne teknologjine IP-MPLS. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se rrjeti i komunikimeve elektronike bazohet në teknologjinë IP-MPLS.

2.3.8. Operatori duhet te disponoje rrjet backbone te mbrojtur nga disa drejtime ne menyre qe te menjanohen problemet ne rastin e demtimit te nje drejtimi. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon rrjet backbone të mbrojtur nga të gjitha drejtimet.

2.3.11. Operatori duhet te kete support për BGP. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.11 operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon suport BGP.

2.3.12. Operatori duhet te disponoje strukture Helpdesk te dedikuar, te kontaktueshem 24/7/365.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon strukturë helpdesk të dedikuar të kontaktueshëm 24/7/365.

Referuar kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kuallifikimit, dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike KSHA vëren se operatori ekonomik Abissnet sh.a ka paraqitur dokumentacionin sipas kushteve të kërkuara nga AK.

Për sa cituam më lart pretendimi Juaj nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk pranohet.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “ALBTELECOM” SHA ku ngre pretendime se:

[...]

shoqeria e kualifikuar “ABISSNET” SHA nuk ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse propozimin teknik në përputhje me kërkesat teknike (kapacitete të bandëith të kërkuara edhe shërbimin back up sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST).

[...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në **shtojcën 5** te dokumenteve të procedurës objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

UKT sh.a ne funksion te permisimit te cilesise se sherbimit ndaj klienteve kerkon blerjen e sherbimit internetit nje sherbim qe behet cdo vit per te pasur lidhje me te gjitha arkat dhe pikat e shperndara ne territorin e Tiranes .Pa kete sherbim nuk kemi arketime apo sherbime tjera qe UKT sha u ofron klienteve te saj.Me shtimin e drejtorise rajonale apo kujdesit ndaj klientit dhe shtrirjen territoriale kerkohet nje shpjetesesi interneti me e madhe dhe nje sherbim me cilesor nga i meparshmi per te rritur sigurine ne komunikim .

1.1 Specifikimet Teknike Sherbimi i Internetit

Mënyra e ofrimit të këtij shërbimi duhet të jetë me transmetim të kablluar, (vetem) me fiber optike sipas tabelës së mesiperme. Te gjitha pikat duhet te kene linje backup me shpejtesine e kerkuar sipas tabelës.

Linjat kryesore fiber te paravendosura ne tabele duhen te jene me dy fije nje per doënload(doënstream) nje per upload(upstream).

Në drejtorinë qendrore pervec linjes kryesore kompania duhet te ofroje linje backup fiber optike kabell tel ose data gsm LTE me shpejtesesi (simetrike) data gsm LTE 40 Mbps me POP te ndryshem.

Në pikat e tjera mënyrë e ofrimit të shërbimit për pikat e tjera përveç linjës kryesore duhet të ofrohet linja back up fibër optike, kabëll ose data sim me shpejtësi simetrike data gsm LTE 40 Mbps me POP të ndryshëm

Kalimi duhet te behet automatike dhe linja backup te jete gjithë kohes online me sherbim.

Ne tabelen e meposhtme aty ku eshte e vendosur me fiber duhet me patjeter te vendoset vetem opsioni fiber. Shpejtesia duhet te jete simetrike.

Disponueshmeria e shërbimit 99.9 %.

Cilesia e shërbimit (QoS) të jetë jo me pak se 95%. Duhet të ofrohen 32 IP publike pa rekorde te keqija.

Ndërfaqe për monitorimin e vazhdueshëm të parametrave të shërbimit të Internetit.

Ping time me serverat neper Europe te jete me pak se 60 ms Linja te jete e optimizuar per protokollet e VOIP (latency dhe jitter te ulet)

Kompania brenda harkut kohor 1 vjecar duhet te pergjigjet deri ne 10 ndryshime pikash pozicionesh gjeografike nga ato te caktuara ne table.

Kompania duhet te parashikojë deri ne 10 pika te reja me kapacitet 32 Mbps/s

Shpejtesia e matjes se internetit duhet te behet duke pinguar servera te ndryshem ne Europe nepermjet ëbsite te ndryshem qe ofrojne sherbime testimi shpejtesie dhe jo peer to peer doënload .”

III.1.2. Referuar shyqrtimit të këtij pretendimi të ankimuesit autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes lidhur me trajtimin e ankesës është shprehur se:

“Së pari referuar pretendimeve të shoqërisë ankimuese se shoqëria “Abissnet” sh.a nuk ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse propozimin teknik në përputhje me kërkesat teknike (kapacitete të bandëith të kërkuara dhe shërbimin bavk up sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST), nuk ka ofruar një plan back up deri në pikën fundore, ju bëjmë me dije se Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin propozim teknik si pjesë të dokumentacionit kualifikues.

Përderisa Autoriteti Kontraktor nuk ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit që operatorët pjesëmarrës të paraqesin propozim teknik si pjesë të dokumentacionit kualifikues, atëherë operatorët ekonomikë nuk kanë qënë të detyruar të paraqesin në sistemin e prokurimeve elektronike propozimin teknik.

Por megjithatë nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik Abissnet sh.a ka paraqitur propozim teknik pavarësisht faktit se nuk është kërkuar nga AK.

Akoma më tej Ju bëjmë me dije se në ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” neni 124/1 parashikohet...

1. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të ndjekë zbatimin e kontratës sipas kushteve në bazë të të cilave është nënshkruar, për të garantuar se ajo zbatohet në kohën, cilësinë dhe vlerën e përcaktuar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dukumentet e tenderit dhe me legjislacionin në fuqi.

Në VKM-në nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet neni 107/1, 107/3 ...

1). Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore të autorizuar me ligj mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

3). Për t’u siguruar nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, autoriteti/enti kontraktor duhet të monitorojë zbatimin e kontratës sipas një plani zbatimi. Autoriteti/enti kontraktor, gjatë kryerjes së kontrolleve mban procesverbal me shkrim në prani të kontraktorit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

Në bazë të dispozitave ligjore të mësipërme Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën e monitorimit të kontratës gjatë zbatimit të kësaj të fundit.

Nëse Autoriteti kontraktor do të konstatojë gjatë zbatimit se kontraktuesi nuk ralizon kontratën sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga vetë AK, atëherë ky i fundit gëzon të drejtën e vendosjes të penaliteteve deri në prishjen e kontratës.

Për sa cituam më lart pretendimi i ankimesit nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk pranohet.

III.1.3. Në nenin 36, “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa

sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.4. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.5. Kriteret për kualifikim, vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga

operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.6. Për sa më sipër cituar, nga shqyrtimi i dokumentacionit KPP konstaton se, autoriteti kontraktor në *Shtojcën 5, “Formulari i Specifikimeve Teknike”*, si dhe në *Shtojcën 7, 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit* nuk ka kërkuar në asnjë moment që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të paraqesin një *propozim teknik* si pjesë e dokumentacionit të kërkuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik “ABISSNET” SHA nuk ka dorëzuar në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse *propozimin teknik* në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në DST, nuk qëndron pasi dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “ABISSNET” SHA është në përputhje me atë çfarë është kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ALBTELECOM” SHA nuk qëndron.

III.1.7. Lidhur me pretendimin e dytë të ankimuesit “ALBTELECOM” SHA ku ngre pretendime se, si më poshtë vijon:

[...]

“Gjithashtu, nga ana e operatorit ekonomik Abissnet sh.a, nuk është paraqitur dokumentacioni i plotë në prputhje me Shtojcën 9, si dhe deklaratat e posaçme për efekt të dokumentacionit provues sipas pikave: 2.3.7, 2.3.8, 2.3.11, 2.3.12, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit”

[...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.8. Në *Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, pikat **2.3.7, 2.3.8, 2.3.11, 2.3.12 “Kapaciteti teknik”** të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

“2.3.7. Rrjeti i komunikimeve elektronike (Data dhe Internet) te operatorit duhet te bazohet ne teknologjine IP-MPLS. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se rrjeti i komunikimeve elektronike bazohet në teknologjinë IP-MPLS.

2.3.8. Operatori duhet te disponoje rrjet backbone te mbrojtur nga disa drejtime ne menyre qe te menjanohen problemet ne rastin e demtimit te nje drejtimi. Për të dëshmuar

përbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon rrjet backbone të mbrojtur nga të gjitha drejtimet.

2.3.11. *Operatori duhet te kete support për BGP. Për të dëshmuar përbushjen e kriterit 2.3.11 operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon suport BGP.*

2.3.12. *Operatori duhet te disponoje strukture Helpdesk te dedikuar, te kontaktueshem 24/7/365.*

Për të dëshmuar përbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon strukturë helpdesk të dedikuar të kontaktueshëm 24/7/365.”

III.1.9. Referuar shqyrtimit të këtij pretendimi të ankimuesit autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes lidhur me trajtimin e ankesës është shprehur se:

“Së dyti në formularin e ankesës operatori ekonomik Albtelecom sh.a pretendon se operatori ekonomik Abbissnet sh.a nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë në përputhje me shtojcën 9 si dhe deklaratat e posaçme për efekt të dokumentacionit provues sipas pikave 2.3.7, 2.3.8, 2.3.11, 2.3.12 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Komisioni i Shqyrtimit të ankesave pasi mori në shqyrtim kushtet e veçanta të kualifikimit në të cilën është kërkuar si më poshtë cituar:

2.3.7. Rrjeti i komunikimeve elektronike (Data dhe Internet) te operatorit duhet te bazohet ne teknologjine IP-MPLS. Për të dëshmuar përbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se rrjeti i komunikimeve elektronike bazohet në teknologjinë IP-MPLS.

2.3.8. Operatori duhet te disponoje rrjet backbone te mbrojtur nga disa drejtime ne menyre qe te menjanohen problemet ne rastin e demtimit te nje drejtimi. Për të dëshmuar përbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon rrjet backbone të mbrojtur nga të gjitha drejtimet.

2.3.11. Operatori duhet te kete support për BGP. Për të dëshmuar përbushjen e kriterit 2.3.11 operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon suport BGP.

2.3.12. Operatori duhet te disponoje strukture Helpdesk te dedikuar, te kontaktueshem 24/7/365.

Për të dëshmuar përbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë nje deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon strukturë helpdesk të dedikuar të kontaktueshëm 24/7/365.

Referuar kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike KSHA vëren se operatori ekonomik Abissnet sh.a ka paraqitur dokumentacionin sipas kushteve të kërkuara nga AK.

Për sa cituam më lart pretendimi Juaj nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk pranohet.”

III.1.10. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.11. Në nenin 41 pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.

III.1.12. Kriteret për kualifikim, vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si

të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

III.1.13. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet, se autoriteti kontraktor në **Shtojcën 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pikat: 2.3.7, 2.3.8, 2.3.11, 2.3.12**, ka kërkuar që nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në përmbushje të këtyre pikave të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës deklarojnë se i përmbush këto kriterë.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik “ABISSNET” SHA nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë në përputhje me *shtojcën 7*, nuk qëndrojnë pasi përmes dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “ABISSNET” SHA vërteton se ka dorëzuar deklaratat e kërkuara në pikat: 2.3.7, 2.3.8, 2.3.11, 2.3.12 të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim duke përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ALBTELECOM” SHA nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 , pika 1 dhe 2 e nenit 115 dhe neni 118 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALBTELECOM” SHA, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur- e thjeshtuar- Shërbim, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-23552-03-30-2022, me objekt: “Shërbim interneti për

UKT sh.a” me fond limit 4.003.700 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë SHA.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ALBTELECOM” SHA.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri